



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm-Generalni Sekretar- Secretary General

Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, përkatësisht Nenit 31, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 13.03.2008, si dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/41, i datës 25.09.2014 për emërimin e panelit të posaçëm (ad hoc) për identifikimin dhe rekomandimin e kandidatëve për anëtar të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit shpall:

K O N K U R S

Për Anëtar të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike

I. Inspektor i Inxhinierisë

Kualifikimet e nevojshme:

- ✓ Diploma e fakultetit në inxhinieri.

Kualifikimet e dëshirueshme:

- a.) Posedues i licencës së pilotit të linjave ajrore komerciale apo private me certifikatë mjekësore të klasës së parë apo të dytë;
- b.) Njohuri në fushën e aviacionit;
- c.) Njohuri mbi mekanikën dhe/ose sistemet elektronike të aeroplanëve që përdoren për s0hërbimet e navigimit ajror;
- d.) Njohuri mbi menaxhimin e projekteve.

Kualifikimet e përgjithshme për pozitat e lartshënuara

Neni 31, paragrafi 31, pika 7, e Ligjit mbi Aviacionin Civil ka përcaktuar kualifikimet minimale vijuese për inspektorët e KHAIA:

- Te ketë njohuri te konsiderueshme te gjuhës angleze
- Të ketë përvojë te konsiderueshme teknike në industrinë e aviacionit,
- Të mos jete shpallur fajtor për veprë penale,
- Të mos ketë interes direkt apo indirekt monetar, financiar apo ndonjë interes tjetër në çfarëdo organizate afariste e cila është e angazhuar në sektorin e aviacionit civil, dhe
- Të jetë person me moral të lartë dhe integritet profesional.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për postin anëtarit të KHAIA duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në.
- Letër motivimin.
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës dhe kërkesa tjera të parapara me ligjin për aviacionin civil)
- Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime.
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Kandidatët të cilët emërohen anëtar të KHAIA, do ti përmbahen nenit 31.9 të Ligjit për Aviacionin Civil.

Paga parashihet sipas Buxhetit të Kosovës.

Dokumentacionet duhet të jenë në pliko (zarf) të mbyllur dhe të dorëzohen në Sekretariatit Koordinues i Qeverisë, kati i I -rë, zyra nr. 105, Ndërtesa e Qeverisë.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038 200 14-400.

Kërkesat që dorëzohen pasi të mbyllet afati i konkursit nuk do të pranohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatet e përzgjedhur për listën e ngushtë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës 08 tetor 2014 deri më datën 22 tetor 2014).